



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 67

Tiranë – E martë, 15 prill 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Financave nr. 54, datë 20.3.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100, datë 20.7.2023, “Për përcaktimin e tarifave për pajisjen e shtetasve shqiptarë dhe të huaj me dokumente biometrike”..... 7691
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 49, datë 27.3.2025	Për miratimin e rregullores “Mbi përcaktimin e masave për zbatimin e skemës së klasifikimit të riskut”..... 7692
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 342, datë 9.4.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.... 7698
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 343, datë 9.4.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë 7699
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 344, datë 9.4.2025	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 839, datë 21.10.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”..... 7700
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 345, datë 9.4.2025	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 616, datë 9.8.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Andorës”..... 7700
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 346, datë 9.4.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Danimarkës... 7700
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 5119, datë 9.4.2025	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare..... 7701

Vendim i Gjykatës Kushtetuese
nr. 10, datë 13.3.2025

Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1447, datë 8.4.2024,
të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me
Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë..... 7701

Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Mark Pemat..... 7709



UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 54, datë 20.3.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT TË
MINISTRIT TË BRENDSHËM DHE
MINISTRIT TË FINANCAVE DHE
EKONOMISË NR.100, DATË 20.7.2023,
“PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR
PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË
DHE TË HUAJ ME DOKUMENTE
BIOMETRIKE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 5, të ligjit nr. 8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar; të pikës 8, të vendimit nr. 80, datë

14.2.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë aksionare për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike”, ministri i Brendshëm dhe ministri i Financave,

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr.100, datë 20.7.2023, “Për përcaktimin e tarifave për pajisjen e shtetasve shqiptarë dhe të huaj me dokumente biometrike”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1.Në pikën 1, bëhen këto ndryshime:

a) në fjalinë e parë, pas fjalës “Tarifat...” shtohet togfjalëshi “për blerjen e kuponit fizik ose elektronik...”;

b) tabela ku paraqiten tarifat për blerjen e kuponit fizik ose elektronik për pajisjen me dokumente biometrike, zëvendësohet me tabelën, si më poshtë:

Kategoria	Emërtimi	Vlera e kuponit	Monedha	Vlera në lekë		
				Vlera pa TVSH	TVSH	Total
Letërnjoftim	Standard	1,500	LEK	1,500	0	1,500
	Për ambasadë (ITA, GRC)	12	EUR	1,354	0	1,354
	Për aplikim të shpejtë	3,00	LEK	3,000	0	3,000
	Për Ambasadën në SHBA	18	USD	1,879	0	1,879
	Për ambasadat në vendet EU	16	EUR	1,805	0	1,805
	Për Ambasadën në Mbretërinë e Bashkuar	13	GBP	1,673	0	1,673
	Për ambasadën në vendet Aziatike	18	USD	1,879	0	1,879
	Për Ambasadën në Zvicër	18	CHF	2,060	0	2,060
	Për Ambasadën në Danimarkë	-	DKK	-	-	-
Pasaporta	Standard	7,500	LEK	6,250	1,250	7,500
	Për aplikim të shpejtë	18,00	LEK	15,000	3,000	18,000
	Për ambasadë (ITA, GRC)	130	EUR	12,222	2,444	14,666
	Për Ambasadën në SHBA	240	USD	20,883	4,177	25,059
	Për ambasadat në vendet EU	170	EUR	15,982	3,196	19,178
	Për Ambasadën në Mbretërinë e Bashkuar	130	GBP	13,942	2,788	16,730
	Për ambasadën në vendet Aziatike	240	USD	20,883	4,177	25,059
	Për Ambasadën në Zvicër	240	CHF	19,460	3,892	23,352
	Për Ambasadën në Danimarkë	-	DKK	-	-	-
Leje qëndrimi	Për leje qëndrimi	5,700	LEK	4750	950	5,700
Letërnj. refugj. dok. udhëtimi	Standard ID	1,500	LEK	1,500	0	1,500
	Standard për pasaporta	7,500	LEK	6,250	1,250	7,500

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet shoqëria “IdentiTek” sh.a. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

**URDHËR**

Nr. 49, datë 27.3.2025

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“MBI PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR
ZBATIMIN E SKEMËS SË KLASIFIKIMIT
TË RISKUT”¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 112, të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar; dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”, dhe urdhrin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 156, datë 23.7.2024, “Për miratimin e rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Mbi përcaktimin e masave për zbatimin e skemës së klasifikimit të riskut”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

RREGULLORE**MBI PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR
ZBATIMIN E SKEMËS SË KLASIFIKIMIT
TË RISKUT**

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton masat për zbatimin e skemës së klasifikimit të riskut (“ERCS”) të përcaktuar në urdhrin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 156, datë 23.7.2024, “Për miratimin e rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut”.

Neni 2

Përkufizimet

1. Për qëllime të kësaj Rregulloreje, zbatohen përkufizimet në nenin 2 të Rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut, të miratuar me urdhrin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 156, datë 23.7.2024, “Për miratimin e rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut”, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Metodologjia ARMS-ERC” nënkupton metodologjinë e zhvilluar nga grupi i punës i industrisë “Zgjidhjet e menaxhimit të riskut të linjës ajrore” (ARMS) për vlerësimin e risqeve operationale;

2. “ATM” nënkupton menaxhimin e trafikut ajror siç përcaktohet në pikën 10, të nenit 2 të udhëzimit nr. 5, datë 3.6.2010 “Kudri rregullativ në qiellin e vetëm evropian”, që përaftron Rregulloren e KE-së nr. 549/2004;

3. “Rezultati i ashpërsisë/shkallës së rëndësisë në ajër e ATM-së” nënkupton pjesën e metodologjisë RAT që vlerëson performancën e operimit ajror të ngjarjes;

4. “Rezultati i ashpërsisë/shkallës së rëndësisë në tokë të ATM-së” nënkupton pjesën e metodologjisë RAT që vlerëson performancën e sistemit (procedurat, pajisjet dhe njerëzit) të sistemit të ATM-së;

¹ Ky urdhër përaftron plotësisht Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 2021/2082, të datës 26 nëntor 2021, që përcakton masat për zbatimin e Rregullores (BE) nr. Faqe | 7692

376/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, në lidhje me skemën e përbashkët evropiane të klasifikimit të riskut, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 426, datë 29.11.2021.



5. “Rezultati i përgjithshëm i ashpërsisë/shkallës së rëndësisë së ATM-së” nënkupton rezultati i ashpërsisë/shkallës së rëndësisë së ATM-së në tokë dhe rezultati i ashpërsisë/shkallës së rëndësisë në ajër të ATM-së, të kombinuara në një pikë të vetme;

6. “Metodologjia RAT” nënkupton metodologjia e Mjetit të Analizës së Riskut e zhvilluar nga Eurocontrol e përdorur për të klasifikuar ngjarjet që lidhen me sigurinë në operim në fushën e ATM-së;

7. “Eurocontrol” është Organizata Evropiane për Sigurinë e Lundrimit Ajror e krijuar nga Konventa Ndërkombëtare e 13 dhjetorit 1960, në lidhje me Bashkëpunimin për Sigurinë e Lundrimit Ajror;

8. “Agjencia” është Agjencia e Bashkimit Evropian për Sigurinë e Aviacionit.

Neni 3

Rishikimi, ndryshimi dhe miratimi i klasifikimit të riskut të sigurisë në operim

1. Autoriteti i Aviacionit Civil shqyrton dhe, nëse është e nevojshme, ndryshon dhe miraton klasifikimin e riskut të sigurisë në operim që përmbahet në raportin e ngjarjeve të ngjarjes në fjalë në përputhje me ERCS, siç përcaktohet në urdhrin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 156, datë 23.7.2024, “Për miratimin e rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut”.

2. Pa cenuar pikën 1, Autoriteti i Aviacionit Civil, kur konverton klasifikimin e riskut të sigurisë në operim, të përcaktuar nëpërmjet metodologjive ARMS/ERC 4x4 ose RAT “ATM Total”, përdor procedurën e konvertimit të drejtpërdrejtë të përcaktuar në aneksin e kësaj Rregulloreje. Për klasifikimet e riskut të sigurisë në operim të përcaktuara nëpërmjet metodologjive të tjera, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të përdorë procedurën manuale të konvertimit të përcaktuar në pikën 2 të aneksit, ose procedura të tjera konvertimi sipas nevojës, për sa kohë që është arritur një klasifikim ekuivalent ERCS.

Neni 4

Monitorimi dhe përmirësimi i ERCS-së

1. Kur të jetë e zbatueshme sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, duke filluar nga data 31 mars 2026 dhe çdo 5 vjet më pas, AAC-ja merr

masa t’i sigurojë Komisionit dhe Agjencisë një raport mbi përdorimin e ERCS-së.

2. Informacion i marrë në përputhje me pikën 1 të këtij neni, si dhe informacione të tjera që Agjencia mund të marrë në lidhje me zbatimin e ERCS-së, rishikohen nga Agjencia. Rishikimi nga Agjencia mund të marrë parasysh ekspertizën e rrjetit të analistëve të sigurisë së aviacionit (NoA) dhe grupeve përkatëse të ekspertëve që mund të krijohen nga Agjencia.

Neni 5

Monitorimi i përputhshmërisë me skemat e tjera të klasifikimit të riskut

1. Procedurat e konvertimit të përcaktuara në aneks i nënshtrohen rishikimit të rregullt sipas rishikimeve të bëra nga Agjencia për të siguruar përputhshmërinë në vijimësi. Rishikimi mund të marrë parasysh ekspertizën e NoA-s dhe grupeve përkatëse të ekspertëve që mund të krijohen nga Agjencia.

2. Kur është e zbatueshme, Autoriteti i Aviacionit Civil merr masa për t’i njoftuar Komisionit dhe Agjencisë përdorimin e procedurës manuale të konvertimit të përcaktuar në pikën 2 të aneksit dhe procedurat e tjera të konvertimit të përmendura në pikën 2 të nenit 3 të kësaj Rregulloreje.

ANEKS

PROCEDURAT E KONVERTIMIT NGA REZULTATI I ANALIZËS SË RISKUT (RAT) DHE ZGJIDHJET E MENAXHIMIT TË RISKUT TË AVIACIONIT – KLASIFIKIMI I RISKUT TË NGJARJEVE (ARMS-ERC) NË REZULTATET E SKEMËS SË KLASIFIKIMIT TË RISKUT (ERCS)

Ky aneks përcakton procedurat e konvertimit nga rezultatet e RAT-së dhe ARMS ERC në rezultatin ERCS të përcaktuar në hapin 2 të aneksit të Rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut, të miratuar me urdhrin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 156, datë 23.7.2024, “Për miratimin e rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut”.

Procedurat e mëposhtme të konvertimit sigurojnë një konvertim të drejtpërdrejtë ose manual për të marrë një klasifikim ERCS ekuivalent me

rezultatet RAT dhe/ose ARMS – ERC në përputhje me nenin 3 të kësaj Rregulloreje.

1. KONVERTIMI DIREKT


Procedura e detyrueshme e konvertimit përbëhet nga dy proceset e mëposhtme të punës:

- Procesi i punës 1 – siguron një konvertim të drejtpërdrejtë për të marrë rezultatin e ashpërsisë/shkallës së rëndësisë ERCS;

- Procesi e punës 2 – siguron konvertim të drejtpërdrejtë për të marrë rezultatin e probabilitetit ERCS.

Figura 1 tregon një përmbledhje të procedurave. Pika e fillimit të procesit është kutia “raporti i ngjarjes i dorëzuar” dhe rezultati është kutia “Rezultati ekuivalent ERCS”. Vijat me pika në figurën 1 tregojnë se kërkohet vetëm një burim për secilin rezultat të procesit.

Figura 1. Procedurat e konvertimit



1.1. PROCESI I PUNËS 1 – Rezultati i ashpërsisë/shkalla e rëndësisë së ERCS-së

a) Informacioni “Kategoria e ngjarjes” dhe “Grupi masiv”

- Nëse raporti i ngjarjes përmban informacion mbi “kategorinë e ngjarjes” së ngjarjes në fjalë dhe “grupin masiv”, atëherë këto mund të konvertohen në rezultatin ERCS të ashpërsisë/ shkallës së rëndësisë së rezultatit të aksidentit të mundshëm”. Hapi tjetër është shkronja “b” e figurës 1.

- Nëse raporti i ngjarjes nuk përmban informacion në lidhje me “kategorinë e ngjarjes” ose “grupin masiv”, ose të dyja, konvertimi i drejtpërdrejtë nuk është i mundur. Nëse përdoret konvertimi manual i përshkruar në pikën 2 të këtij aneksi, atëherë hapi tjetër është shkronja “d” e figurave 1 dhe 5.

b) “Kategoria e ngjarjes” dhe konvertimi i zonës kryesore të riskut ERCS (KRA)

- Nëse “kategoria e ngjarjes” e raportit të ngjarjes korrespondon drejtpërdrejt me atë të zonave kryesore të riskut të ERCS-së të përcaktuara në pikën 1.2 të aneksit të Rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut, të miratuar me urdhrin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 156, datë 23.7.2024, “Për miratimin e rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut”, atëherë hapi tjetër është shkronja “c” e figurës 1.

- Për raportet e ngjarjeve me “kategoritë e ngjarjeve” të ndryshme nga zonat kryesore të riskut të ERCS-së, nuk ka konvertim të drejtpërdrejtë. Nëse përdoret konvertimi manual i përshkruar në pikën 2 të këtij aneksi, atëherë hapi tjetër është shkronja “D” e figurave 1 dhe 5.

c) Rezultati i ERCS-së i “Ashpërsisë/shkallë së rëndësisë së rezultatit të aksidentit të mundshëm” – konvertim i drejtpërdrejtë

- Nëse raporti i ngjarjes përmban informacion në lidhje me “kategorinë e ngjarjes” dhe “grupin masiv”, atëherë rezultati i ashpërsisë shkalla e rëndësisë konvertohet drejtpërdrejt në një rezultat të përshtatshëm të ERCS-së të “ashpërsisë/shkallës së rëndësisë të ndodhjes së aksidentit të mundshëm”. Rezultati është “k”, i cili jep shifrën e parë që korrespondon me vlerën alfabetike që rezulton nga logaritmi e ashpërsisë/shkallës së rëndësisë/të ngjarjes (rezultati i ashpërsisë A deri në X).

1.2. PROCESI I PUNËS 2 – Rezultati i probabilitetit ERCS

e) Raporti i ngjarjes i vlerësuar duke përdorur RAT

Nëse raporti i ngjarjes është vlerësuar duke përdorur metodologjinë RAT:

- Raportet e ngjarjeve që kanë një klasifikim RAT të rezultateve të ashpërsisë/shkallës së rëndësisë “ATM e përgjithshme” mund të vendosen drejtpërdrejt në kolonat e probabilitetit ERCS siç shpjegohet në hapin “g” të figurës 1;

- Raportet e ngjarjeve që kanë vetëm një rezultat RAT të ashpërsisë/shkallës së rëndësisë të “ATM në

tokë” duhet të konvertohen manualisht për të siguruar rezultatin e probabilitetit ERCS. Nëse përdoret konvertimi manual i përshkruar në pikën 2 të këtij aneksi, atëherë hapi tjetër është “L” e figurës 5;

- Në rastin e raporteve të ngjarjeve të koduara si “ngjarje specifike për ATM”, konvertimi midis rezultateve RAT dhe ERCS nuk është i mundur.

f) Rezultati RAT i ashpërsisë/shkallës së rëndësisë të “ATM të përgjithshme”

- Nëse një raport ngjarjeje përmban rezultatin e ashpërsisë/shkallës së rëndësisë të “ATM-së së përgjithshme”, atëherë hapi tjetër është shkronja “g” e figurës 1.

g) Kolona ERCS “Probabiliteti i rezultatit të aksidentit të mundshëm” i konvertuar nga vlera “ATM e përgjithshme” e RAT-së (e rëndësishme vetëm për vlerat A, B, C, E)

Për raportet e ngjarjeve me një klasifikim të ashpërsisë/shkallës së rëndësisë “ATM e përgjithshme” (A, B, C, E), zbatohet konvertimi i drejtpërdrejtë i mëposhtëm në kategoritë e probabilitetit ERCS:

Figura 2. Konvertimi i rezultatit të ashpërsisë/ shkallës së rëndësisë “ATM e përgjithshme” i RAT-së në rezultatin e probabilitetit ERCS

Kategoritë e probabilitetit ERCS										
Rezultati i barrierës përkatëse	9	8	7	6	5	4	3	2	1	0
Shuma e peshës së barrierave	17-18	15-16	13-14	11-12	9-10	7-8	5-6	3-4	1-2	0
Probabiliteti	10^{-9}	10^{-8}	10^{-7}	10^{-6}	10^{-5}	10^{-4}	10^{-3}	10^{-2}	10^{-1}	1
Përshkrimi	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 1,000 milion herë	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 100 milion herë	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 10 milion herë	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 1 milion herë	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 100,000 herë	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 10,000 herë	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 1,000 herë	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 100 herë	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 10 herë	Aksidentet e ndodhura

h) Raportet e ngjarjeve të klasifikuara duke përdorur metodologjinë ARMS-ERC

- Për raportet e ngjarjeve që janë shënuar sipas ARMS-ERC, hapi tjetër është shkronja “i” e figurës 1.

- Për raportet e ngjarjeve që nuk janë vlerësuar sipas metodologjisë ARMS-ERC, hapi tjetër është shkronja “M” e figurës 5.



i) Matrica standarde 4x4 ARMS-ERC

Nëse matrica 4x4 ARMS-ERC e paraqitur në figurën 3 përdoret për të shënuar raportin e ngjarjes, atëherë hapi tjetër është shkronja “j” e figurës 1.

Figura 3. Matrica standarde 4x4 ARMS-ERC

Pyetje 2

Cili ishte efektiviteti i barrierave të mbetura midis kësaj ngjarjeje dhe skenarit më të mundshëm të aksidentit?			
Efektive	E kufizuar	Minimale	Jo efektive
50	102	502	2500
10	21	101	500
2	4	20	100
1			

Pyetje 1

Nëse kjo ngjarje do të ishte përshkallëzuar në një aksident, cili do të ishte aksidenti më i mundshëm?	
Aksident katastrofik	Humbje aeroplani ose vdekje të shumta (3 ose më shumë)
Aksident i madh	1 ose 2 viktima, lëndime të shumta të rënda, dëmtime të mëdha në avion
Lëndime ose dëmtime të lehta	Lëndime të lehta, dëmtime të vogla të avionit
Asnjë rezultat aksidenti	Nuk mund të ketë dëmtime ose lëndime të mundshme

Skenari tipik i aksidentit
Humbje kontrolli, përplasje në ajr, zjarr i pakontrollueshëm në bord, shpërthime, dështim total strukturor i avionit, përplasje me terrenin
Përplasje në pistë me shpejtësi të madhe, lëndime nga turbulencat e mëdha
Aksident nga shtyrjet, dëmtime të vogla nga moti
Çdo ngjarje që nuk mund të përshkallëzohet në një aksident, edhe nëse mund të ketë pasoja operationale (p.sh. devijim, vonesë, sëmundje individuale)

j) Rezultati i ERCS-së “Probabiliteti i rezultatit të aksidentit të mundshëm” – konvertim i drejtpërdrejtë

Nëse raporti i ngjarjes përmban një vlerësim të “Efektivitetit të Barrierës” ARMS, atëherë për të përcaktuar rezultatin ERCS të “Probabilitetit të rezultatit të aksidentit të mundshëm” përdoret një konvertim i drejtpërdrejtë i mëposhtëm në matricën ERCS.

Figura 4. Konvertimi i kategorive të probabilitetit ARMS-ERC në ERCS

	Efektive				E Limituar		Minimale		Jo efektive	
Rezultati i barrierës përkatëse	9	8	7	6	5	4	3	2	1	0
Shuma e peshës së barrierave	17-18	15-16	13-14	11-12	9-10	7-8	5-6	3-4	1-2	0
Probabiliteti	10^{-9}	10^{-8}	10^{-7}	10^{-6}	10^{-5}	10^{-4}	10^{-3}	10^{-2}	10^{-1}	1
Përshkrimi	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 1,000 milion herë	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 100 milion herë	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 10 milion herë	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 1 milion herë	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 100,000 herë	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 10,000 herë	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 1,000 herë	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 100 herë	Barrierat e mbetura parashikohen të dështojnë 1 në 10 herë	Aksidentet e ndodhura

k) Rezultati ekuivalent ERCS

Kombinimi i rezultateve të ERCS-së “Ashpërsia/shkalla e rëndësisë e rezultatit të aksidentit të mundshëm” dhe “Probabiliteti i rezultatit të aksidentit të mundshëm” kombinohen në matricën ERCS për të gjeneruar një rezultat ekuivalent ERCS, siç përcaktohet në hapin 2 të aneksit të Rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut, të miratuar me urdhrin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i


Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 156, datë 23.7.2024, “Për miratimin e rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut”.

2. KONVERTIMI MANUAL

Ky konvertim manual përbëhet nga dy proceset e mëposhtme të punës:

- Procesi i punës 1 – siguron një konvertim manual për të marrë rezultatin e ashpërsisë/shkalla e rëndësisë ERCS,
- Procesi i punës 2 – siguron një konvertim manual për të marrë rezultatin e probabilitetit ERCS.

Figura 5. Konvertimi manual



2.1. PROCESI I PUNËS 1

D. Rezultati i ERCS-së i “Ashpërsisë/shkallës së rëndësisë së ndodhjes së aksidentit të mundshëm” – konvertimi manual

- Nëse raporti i ngjarjes nuk përmban informacion në lidhje me “kategorinë e ngjarjes” ose “grupin masiv”, ose të dyja, atëherë metodologjia ERCS e përcaktuar në aneksin e Rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut, të miratuar me urdhrin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 156, datë 23.7.2024, “Për miratimin e rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut” zbatohet për të përcaktuar “Rezultatin e aksidentit të mundshëm ose zonën kyçe të riskut. Rezultati përfundimtar është “k”, i cili jep shifrën e parë që korrespondon me vlerën alfabetike që rezulton nga llogaritja e ashpërsisë/shkallës së rëndësisë të ngjarjes (rezultati i ashpërsisë A deri në X).

2.2. PROCESI I PUNËS 2

1. Kolona ERCS “Probabiliteti i ndodhjes së aksidentit të mundshëm” – procedura manuale

- Për raportet e ngjarjeve që nuk përmbajnë ashpërsinë/shkallën e rëndësisë “ATM e përgjithshme”, nuk ka asnjë konvertim të drejtpërdrejtë në rezultatin “Probabiliteti i ndodhjes së aksidentit të mundshëm” të ERCS-së.

Ashpërsia/shkalla e rëndësisë e “ATM-së në tokë” mund të sigurojë megjithatë një konvertim të pjesshëm, duke hartuar vlerësimin e barrierës “ATM në tokë” dhe procesin e vlerësimit të pengesës ERCS të përcaktuar në pikën 2.1.3 të aneksit të Rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut, të miratuar me urdhrin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 156, datë 23.7.2024, “Për miratimin e rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut”.



m) Rezultati i ERCS-së “Probabiliteti i rezultatit të aksidentit të mundshëm” – procesi manual

Nëse raportet e ngjarjeve nuk përdorin matricën 4x4 ARMS-ERC për të vlerësuar ngjarjen, për të gjeneruar një rezultat ERCS “Probabiliteti i ndodhjes së aksidentit të mundshëm”, vlera e vlerësimit të barrierës ARMS-ERC konvertohet në vlerësimin e barrierës ERCS të përcaktuar në pikën 2.1. 3 të aneksit të Rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut, të miratuar me urdhrin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 156, datë 23.7.2024, “Për miratimin e rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut”.

k) Rezultati ekuivalent ERCS

Kombinimi i rezultateve të ERCS-së “Ashpërsia/shkalla e rëndësisë e ndodhjes së aksidentit të mundshëm” dhe “Probabiliteti i ndodhjes të aksidentit të mundshëm” kombinohen në matricën ERCS për të gjeneruar një rezultat ekuivalent ERCS, siç përcaktohet në hapin 2 të aneksit të Rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut, të miratuar me urdhrin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 156, datë 23.7.2024, “Për miratimin e rregullores mbi skemën e klasifikimit të riskut”.

URDHËR

Nr. 342, datë 9.4.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht,

nga shteti i Polonisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1	Łódzkie	Skiernewice	Maków*
2	Dolnośląskie	Trzebnica	Wisznia Mała*
3	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Środa Wielkopolska*
4	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Raszków*
5	Wielkopolskie	Poznań	Kleszczewo*
6	Wielkopolskie	Września	Miłosław*
7	Dolnośląskie	Wolów	Wrocław*
8	Śląskie	Gliwice	Toszek*
9	Śląskie	Częstochowa	Dąbrowa Zielona*
10	Dolnośląskie	Góra	Niechlów*
11	Mazowieckie	Mława	Radzanów*
12	Mazowieckie	Siedlce	Zbuczyn*
13	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Lubawa (rural)*
14	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Biskupiec*
15	Warmińsko-Mazurskie	Ostróda	Dąbrówno*
16	Łódzkie	Sieradz	Warta*
17	Mazowieckie	Żuromin	Bieżuń*
18	Podkarpackie	Jarosław	Jarosław (rural)*
19	Zachodniopomorskie	Goleniów	Osina*
20	Podkarpackie	Ropczyce-Sędziszów	Ostrów*
21	Łódzkie	Kutno	Krośnice*
22	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Kisielice*
23	Warmińsko-Mazurskie	Giżycko	Giżycko (rural)*
24	Łódzkie	Zgierz	Ozorków (rural)*
25	Wielkopolskie	Koło	Grzegorzew*
26	Wielkopolskie	Kępno	Kępno*
27	Lubuskie	Nowa Sól	Kolsko*
28	Wielkopolskie	Kalisz	Żelazków*
29	Warmińsko-Mazurskie	Mragowo	Piecki*
30	Łódzkie	Sieradz	Goszczanów*
31	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*
32	Warmińsko-Mazurskie	Mragowo	Mikolajki*
33	Kujawsko-Pomorskie	Lipno	Lipno (rural)*
34	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Wielichowo*
35	Kujawsko-Pomorskie	Lipno	Kikół*
36	Podkarpackie	Lesko	Olśzanica*
37	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
38	Małopolskie	Myslenice	Siepraw*
39	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Rakoniewice*
40	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Olsztynek*
41	Pomorskie	Malbork	Miloradz*
42	Wielkopolskie	Kościan	Czempiń*
43	Kujawsko-Pomorskie	Żnin	Janowiec Wielkopolski*
44	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzętnik*



45	Mazowieckie	Zuromin	Zuromin*
46	Malopolskie	Tarnów	Wierchoslawice*
47	Wielkopolskie	Chodzież	Margonin*
48	Mazowieckie	Mława	Szeńsk*
49	Wielkopolskie	Krotoszyn	Koźmin Wielkopolski*
50	Lubuskie	Świebodzin	Łagów*
51	Mazowieckie	Mława	Lipowiec Kościelny*
52	Wielkopolskie	Koło	Olszówka*
53	Wielkopolskie	Jarocin	Kotlin*
54	Świętokrzyskie	Staszów	Osiek*
55	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
56	Łódzkie	Poddębice	Wartkowice*
57	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Grodzisk Wielkopolski*
58	Wielkopolskie	Ostrzeszów	Grabów Nad Prosną*
59	Warmińsko-Mazurskie	Ostróda	Ostróda (rural)*
60	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Raszków*
61	Zachodniopomorskie	Świdwin	Polczyn-Zdrój*
62	Wielkopolskie	Pleszew	Pleszew*
63	Wielkopolskie	Jarocin	Jarocin*
64	Wielkopolskie	Poznań	Stęszew*
65	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Kuślin*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 323, datë 3.4.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 343, datë 9.4.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht,

nga shteti i Hungarisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	* Ndarja administrative e nivelit 2
Heves	Füzesabony*
Bács-Kiskun	Kiskőrös*
Békés	Mezőkovácsháza*
Bács-Kiskun	Kiskunmajsa*
Csongrád-Csanád	Kistelek*
Pest	Cegléd*
Csongrád-Csanád	Csongrád*
Bács-Kiskun	Kiskunfélegyháza*
Csongrád-Csanád	Hódmezővásárhely*
Bács-Kiskun	Kecskemét*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.



4. Urdhri nr. 324, datë 3.4.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 344, datë 9.4.2025

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT
NR. 839, DATË 21.10.2024, “PËR DISA
MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES
SË MURTAJËS AFRIKANE TË
DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN
E GJERMANISË”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 839, datë 21.10.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 345, datë 9.4.2025

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR.
616, DATË 9.8.2024, “PËR DISA MAS
MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË
GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E ANDORËS”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 616, datë 9.8.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Andorës”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 346, datë 9.4.2025

**PËR DISA MAS MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E DANIMARKËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht,

nga shteti i Danimarkës, sipas tabelës së mëposhtme:

*Ndarja administrative enivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
Veterinary Inspection Unit East	Roskilde*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

NJOFTIM

Nr. 5119, datë 9.4.2025

**MBI HYRJEN NË FUQI TË
MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE**

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Republikës së Kirgizstanit, për përjashtimin e kërkesave për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, nënshkruar në Nju Jork, më 23.9.2024, do të hyjë në fuqi në datën 3 maj 2025.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM

Nr. 10, datë 13.3.2025

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 13.3.2025, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (Dh) 2024 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Dhurata Boçi, Elvira Boçi, Rosela Boçi, përfaqësuar nga avokatët Oliana Andoni dhe Adriatik Lapaj, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Bashkia Divjakë, përfaqësuar nga nënkryetari Eris Stambolliu.

Drejtoria e Përgjithshme Detare, e përfaqësuar nga zëvendës drejtori i përgjithshëm Tomor Harizi.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përfaqësuar nga drejtori Ilir Proda.



Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, përfaqësuar nga sekretarja e përgjithshme Ledina Beqiraj Agalliu.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm Ledion Lako.

Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga avokatet e shtetit Valbona Legisi dhe Irma Qosja.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1447, datë 8.4.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 21, 42, 131, pika 1, shkronja “P”, pika 1 dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 2 dhe 6, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 50, pika 4, 71 e 71/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuueseve, Dhurata Boçi, Elvisa Boçi dhe Rosela Boçi, të cilat kërkuan pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Bashkia Divjakë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (*Policia e Shtetit*), Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (*MTM*), Agjencia Kombëtare e Bregdetit (*AKB*), Drejtoria e Përgjithshme Detare (*DPD*) dhe Avokatura e Shtetit, të cilat kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Dhurata Boçi (kërkuesja e parë) është nëna e kërkuueseve Elvisa Boçi (kërkuesja e dytë) dhe Rosela Boçi (kërkuesja e tretë). Në datën 9.7.2017, kërkuesja e parë dhe bashkëshorti i saj, njëherazi babai i dy kërkuueseve të tjera, kanë shkuar në plazhin e Divjakës së bashku me kërkuesen e tretë, në atë kohë e mitur në moshën 11 vjeç. Bashkëshorti dhe kërkuesja e tretë kanë shkuar të shohin një ishull të krijuar në det, ndërsa kërkuesja e

parë ka ndenjur në çadër. Pas rreth gjysmë ore kërkuesja e parë ka dëgjuar njerëzit pranë që flisnin për një person të mbytur në det dhe ka parë një autoambulancë. Kur është afruar ka parë kërkuesen e tretë që ishte e shokuar dhe bashkëshortin e pajetë.

2. Me marrjen e njoftimit për ngjarjen është krijuar grupi hetimor i Policisë Gjyqësore, që ka kryer disa veprime procedurale, si këqyrjen e kufomës, ekspertimin mjekoligjor të saj dhe marrjen e deklarimeve nga të pranishmit. Nga ekspertimi mjekoligjor i kufomës është konstatuar se kufoma kishte përmbajtje shkume në rrugët e jashtme të frymëmarrjes, dëmtime të shkaktuara nga një mjet i fortë mprehës, por shkaku i vdekjes nuk mund të përcaktohej, pasi nuk ishte kryer autopsia mjekoligjore. Në vijim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë (*Prokuroria Lushnjë*) në datën 24.7.2017, bazuar në nenet 290, pika 1, shkronja “ç” dhe 291, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se fakti nuk përbënte vepër penale. Sipas Prokurorisë Lushnjë, pavarësisht se ekspertimi mjekoligjor nuk përcaktonte shkencërisht shkaku të vdekjes, duke u bazuar pjesërisht tek ekspertimi dhe deklaratimet e personave të pyetur, nxirrej përfundimi se vdekja ishte aksidentale si rezultat i asfiksionit mekanike nga mbytja në det.

3. Në datën 28.5.2018, kërkuaset kanë ngritur padi në gjykatë me objekt detyrimin e Bashkisë Divjakë, DPD-së, Policisë së Shtetit, MTM-së dhe AKB-së për shpërblimin e dëmit për shkak të humbjes së jetës së bashkëshortit/babait të tyre. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 325, datë 13.3.2019, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin, ndër të tjera, se nga interpretimi i kuadrit ligjor në fuqi, institucionet shtetërore, të thirrura si palë të paditura, nuk legjitimoheshin pasivisht, pasi nuk kishin kryer ndonjë veprim të paligjshëm që të kishte ndikuar në humbjen e jetës së viktimës. Më konkretisht, sipas asaj gjykate, Bashkia Divjakë nuk kishte pajisur asnjë subjekt me leje përdorimi në plazhin e Divjakës; DPD-ja përgjigjet sipas ligjit vetëm për mjetet lundruese dhe ngjarja nuk kishte pasur lidhje me mjetet lundruese; Policia e Shtetit ishte angazhuar plotësisht nëpërmjet planeve të punës për mbarëvajtjen e sezonit turistik, ndaj nuk kishte përgjegjësi për ngjarjen; ndërsa AKB-së ligji nuk i jepte kompetenca për të caktuar roje bregdetare ose marrjen e masave të tjera. Në nxjerrjen e këtij



konkluzioni gjykata e shkallës së parë i është referuar edhe vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, duke arsyetuar se ngjarja nuk përbënte vepër penale.

4. Ndonëse kërkeset kanë paraqitur apel, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 629 (86-2023-903), datë 21.9.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtën linjë arsyetimi, por duke shtuar se organet shtetërore nuk mund të përgjigjen për dëmin jashtëkontraktor, në kushtet kur shkaku i vdekjes së viktimës nuk është përcaktuar nga akti i ekspertimit (*shih paragrafin 2 të vendimit*).

5. Kërkeset kanë paraqitur rekurs, duke parashtruar, ndër të tjera, se qëndrimi i gjykatës së apelit është në kundërshtim me kuadrin ligjor që rregullon kompetencat dhe detyrimet e institucioneve për sigurinë në det e në plazhe dhe se përgjegjësia e tyre nuk buron nga fakti nëse kanë dhënë ose jo leje përdorimi tek subjektet private, por nga detyrimi ligjor për të marrë të gjitha masat e nevojshme që jeta dhe shëndeti i çdo qytetari të jenë të siguruar në plazhe, ndaj ato janë përgjegjëse për humbjen e jetës së familjarit të tyre. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1447, datë 8.4.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se shkaqet e tij haptazi nuk mbështeten në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 58, i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

6. Në datën 1.8.2024, kërkeset i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Në datën 16.10.2024, Kolegji vendosi kalimin në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkeset**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se nga vendimi i Gjykatës së Lartë u janë cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

7.1.1. *E drejta e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit nuk ka shqyrtuar dhe nuk është shprehur për pretendimet lidhur me shkeljet e rënda të ligjit material dhe procedural nga gjykata e apelit. Ndonëse kërkeset kanë identifikuar

përgjegjësitë ligjore të autoriteteve shtetërore për sigurinë në plazhe, Gjykata e Lartë ka legjitimuar vendimin e gjykatës së apelit, e cila ka vlerësuar se autoritetet shtetërore nuk kishin legjitimitet pasiv, duke mos respektuar nenin 15 të Kushtetutës.

7.1.2. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar përse rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58, të ligjit 49/2012. Pretendimet e kërkuueseve kishin natyrë kushtetuese, ndaj Gjykata e Lartë duhet të mbante qëndrim të shprehur për to. Vendimit të gjykatës së apelit i mungon arsyetimi ligjor, duke përsëritur pa asnjë argument vendimin e shkallës së parë. Gjykata e Lartë duhet të kishte shqyrtuar çështjen në seancë e të prishte vendimin e apelit duke e rikthyer për rishqyrtim në po atë gjykatë.

7.2. *E drejta e jetës dhe e drejta për zhdëmtim në përputhje me ligjin*, të garantuara nga nenet 21 dhe 44 të Kushtetutës, sepse organet shtetërore nuk kanë marrë masat e duhura për sigurinë në plazhin e Divjakës dhe si rezultat bashkëshorti/babai i kërkuueseve ka humbur jetën, ndërsa gjykatat e zakonshme nuk i kanë njohur të drejtën e shpërblimit të dëmit kërkuueseve.

8. **Subjekti i interesuar, Bashkia Divjakë**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimet e kërkuueseve nuk qëndrojnë, pasi dëmi nuk është shkaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë prej saj, por për pakujdesi të viktimës, që për të kaluar në pjesën tjetër të ishullit ka shmangur urën me dru dhe se nga mjekësia ligjore nuk është kryer autopsia për të vërtetuar shkakun e vdekjes.

9. **Subjekti i interesuar, DPD-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se ajo nuk ka përgjegjësi në shkaktimin e tragjedisë, pasi ligji e ngarkon me përgjegjësi vetëm për mjetet lundruese dhe detare. Ajo nuk ka detyrë të patrollojë në zonat e plazheve për qëllime pushimi ose mjediset relaksuese. Humbja e jetës së viktimës nuk ka ardhur si rezultat i ndonjë incidenti me mjet lundrues dhe zona ku ka ndodhur ngjarja nuk ka aktivitete lundrimore. Vendimi i Gjykatës së Lartë ka përmbushur standardin kushtetues të arsyetimit, pasi është i qartë, i kuptueshëm dhe nuk ka përplasje mes fakteve.

10. **Subjekti i interesuar, Policia e Shtetit**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar. Gjykata e Lartë ka respektuar të drejtat e



kërkueseve për akses, për t'u dëgjuar dhe mbrojtur. Vendimi i Gjykatës së Lartë, për shkak të natyrës së tij, ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit. Argumentet e dhëna janë të mjaftueshme për të mbështetur mospranimin e rekursit. Vendimi nuk përmban mangësi ose kundërthënie, si dhe nuk rezulton alogjik.

11. **Subjekti i interesuar, MTM-ja**, në mënyrë të përmblodhur, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e procesit të rregullt ligjor është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka dhënë një vendim të drejtë, i cili shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nuk paraqet mangësi të cilat ndikojnë negativisht në drejtim të garantimit të së drejtës, nuk rezulton të jetë jologjik, të ketë kundërthënie ose të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm. Pretendimet nuk kanë natyrë kushtetuese, ndaj i përkasin juridiksionit gjyqësor të gjykatave të zakonshme. MTM-ja ka funksione politikëbërëse, të cilat i ka realizuar plotësisht, ndaj nuk ka përgjegjësi për humbjen e jetës së viktimës. Gjykatat e zakonshme duhet të sqaronin faktin nëse ngjarja ka ndodhur në plazh publik ose privat.

12. **Subjekti i interesuar, AKB-ja**, në mënyrë të përmblodhur, ka prapësuar se u qëndron parashtrimeve të dhëna gjatë gjykimit në gjykatat e zakonshme. Institucioni është krijuar në vitin 2014 dhe nuk ka pasur kompetenca administrimi në vijën bregdetare, në plazhet publike dhe në ato private, të dhëna me qira subjekteve nga njësitë e qeverisjes vendore. Në kohën e ngjarjes vepronin disa vendime të Këshillit të Ministrave për sigurinë në plazhe, që nuk përcaktonin përgjegjësi të AKB-së, ndaj ky institucion nuk duhet të jetë palë në gjykim. Gjykatat e zakonshme duhet të sqaronin nëse personi i mbytur gjendej në plazh publik ose privat. Megjithatë, AKB-ja ka njoftuar institucionet kompetente për rëndësinë e shërbimit të sigurisë (*lifeguard*).

13. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, në mënyrë të përmblodhur, ka prapësuar se:

13.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, pasi:

13.1.1. Gjykata e Lartë nuk ka cenuar *të drejtën e aksesit* të kërkueseve. Ajo ka kryer veprimtarinë seleksionuese dhe ka konstatuar se rekursi nuk ngrinte shkaqet e parashikuara nga neni 58, i ligjit nr. 49/2012, duke vendosur mospranimin e tij. Lidhur me themelin e çështjes, kërkueset kanë marrë përgjigje shteruese nga gjykata e apelit, ndaj

pretendimet e tyre nuk ngrenë problematikë kushtetuese.

13.1.2. Vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit respekton *standardin e arsyetimit të vendimit*, duke mbajtur parasysh natyrën e tij. Ai përmban të dhënat e palëve, vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, pretendimet e ngritura në ankim/rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese, në të cilën i është dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në ankim/rekurs.

13.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së jetës* nuk duhet të merret në shqyrtim, pasi kërkueset *nuk kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion* në kushtet kur ky pretendim nuk është ngritur në recurs. Për më tepër, këtij pretendimi i është dhënë përgjigje shteruese nga gjykatat e faktit, të cilat kanë vlerësuar se institucionet shtetërore nuk kanë kryer veprime të paligjshme, si pasojë e të cilave të jetë shkaktuar vdekja e viktimës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueseve

14. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata vëren se kërkueset, në cilësinë e familjarëve të afërt të viktimës (bashkëshortja dhe dy fëmijët), kanë ngritur padi në gjykatat e zakonshme për të kërkuar shpërblimin e dëmit nga humbja e jetës së tij, proces i cili ka përfunduar me mospranimin e rekursit të tyre nga Gjykata e Lartë. Në kushtet kur ato kundërshtojnë vendimin e Gjykatës së Lartë, kërkueset justifikojnë interesin në çështjen kushtetuese të parashtruar në kuptim të nenit 131,



pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës.

16. Një kriter tjetër ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim individual kushtetues, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 31, datë 3.11.2022; nr. 15, datë 7.5.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata vëren se kërkuueset i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm të vënë në lëvizje prej tyre nëpërmjet padisë, ankimit dhe rekursit, duke i shteruar mjetet juridike në dispozicion nga ana formale. Për sa i takon substancës së pretendimeve, kërkuueset ankohen për procesin gjyqësor të zhvilluar nga Gjykata e Lartë, për të cilin i vetmi mjet juridik në dispozicion është ankimi kushtetues. Ndërsa në lidhje me të drejtën e jetës, duke mbajtur në konsideratë se objekti i gjykimit të zakonshëm ka të bëjë me shpërblimin e dëmit për shkak të humbjes së jetës së familjarit të tyre, Gjykata çmon se ato e kanë ngritur në substancë edhe këtë pretendim, ndaj nuk qëndron prapësimi i subjekteve të interesuara, Policisë së Shtetit dhe Avokaturës së Shtetit, se kërkuueset nuk i kanë shteruar mjetet juridike.

18. Kërkuueset legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 8.4.2024, ndërsa ankimi kushtetues është paraqitur në datën 1.8.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuueset kanë pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor, duke parashtruar se vendimi i mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit për cenimin e së drejtës së jetës së bashkëshortit/babait të tyre nga mungesa e masave të sigurisë nga institucionet publike në plazhin e Divjakës. Sipas tyre, vendimi i Gjykatës së

Lartë i ka dhënë fund një procesi gjyqësor, në të cilin nuk ka marrë përgjigje pyetja se cili institucion shtetëror ishte përgjegjës për të zbatuar rregullat ligjore të sigurisë së jetës dhe shëndetit në plazh, pasi të gjitha institucionet janë vlerësuar se nuk kishin ndonjë detyrim.

20. Lidhur me të drejtën e jetës, e cila ka qenë objekti i gjykimit në gjykatat e zakonshme, Gjykata evidenton se neni 21 i Kushtetutës parashikon se jeta e personit mbrohet me ligj, duke vendosur në këtë mënyrë detyrime pozitive në radhë të parë për ligjvënësin që të parashikojë rregulla ligjore për mbrojtjen e jetës së individit dhe më pas për gjykatat e zakonshme, të cilat kanë përgjegjësinë e verifikimit nëse detyrimet ligjore për mbrojtjen e jetës janë përmbushur nga institucionet shtetërore të ngarkuara nga ligji. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet e kërkuueseve lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar nga Gjykata e Lartë, çmon se pretendimet në thelb kanë të bëjnë me aksesin në gjykatë dhe arsyetimin e vendimit gjyqësor, si aspekte të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Ky i fundit parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë (ku përfshihet edhe e drejta e jetës), nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtave kushtetuese, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

21. Për sa më lart, Gjykata do të analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit, të cilat hyjnë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

22. Kërkuueset kanë parashtruar se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, ndonëse pretendimet e tyre kishin të bënin me shkelje të rënda të ligjit material dhe procedural nga gjykatat e faktit, të cilat kishin rrëzuar padinë e tyre për shpërblimin e dëmit nga humbja e jetës së familjarit të tyre, me arsyetimin se autoritetet shtetërore nuk kishin asnjë përgjegjësi për të zbatuar masat për sigurinë e jetës në plazhin e Divjakës. Sipas tyre ky qëndrim bie ndesh me parimin e nenit 15 të Kushtetutës, sipas të cilit organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Në këtë



mënyrë, sipas kërkuessëve, ato nuk kanë marrë përgjigje nga Gjykata e Lartë për pretendimet e ngritura në rekurs, të cilat kishin natyrë kushtetuese, ndërsa arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë nuk shpjegon përse ato pretendime nuk përbënin shkaqe ligjore për rekurs.

23. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se pretendimet e kërkuessëve janë të pabazuara, pasi Gjykata e Lartë, sipas ligjit, ka kryer veprimtarinë seleksionuese dhe ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në rekurs nuk parashikoheshin nga ligji. Sipas subjekteve të interesuara, kërkuessët kanë marrë përgjigje shteruese për pretendimet e tyre nga gjykatat e faktit, ndaj e drejta e aksesit në gjykatë nuk është cenuar. Po ashtu, sipas tyre, vendimi i Gjykatës së Lartë, për shkak të natyrës së tij – vendim i mospranimit të rekursit, është në përputhje me standardet kushtetuese të arsytimit, pasi tregon pretendimet e ngritura në rekurs dhe vlerësimin me arsyetim të kufizuar që ato nuk parashikohen nga ligji si shkak për rekurs.

24. Gjykata ka pohuar se e drejta e aksesit ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përfshirë rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore. Shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit ose të personave juridikë, duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë procesit të shqyrtimit të procesit (*shih vendimet nr. 70, datë 24.11.2016; nr. 10, datë 4.4.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e *subsidiaritetit* që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues

dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimin nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 33, datë 30.5.2023; nr. 11, datë 10.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se standardi i arsytimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është e drejta e aksesit në gjykim dhe e drejta e ankimit efektiv (*shih vendimin nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Sipas Gjykatës, vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa në thelb shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 7.3.2023; nr. 21, datë 16.4.2015; nr. 37, datë 19.9.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata ripohon se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 14, datë 14.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 3, datë 21.1.2025; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata do të verifikojë nëse kërkuessët kanë marrë



përgjigje përfundimtare për pretendimin lidhur me dëmin e shkaktuar nga humbja e jetës së familjarit të tyre, për shkak të mungesës së masave të sigurisë në plazh, duke shqyrtuar nëse vendimi i mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet kushtetuese të arsytimit.

30. Fillimisht, Gjykata vëren se në kohën e humbjes së jetës së familjarit të kërkueseve, rregullat e sigurisë në plazhe parashikoheshin nga VKM-ja nr. 321, datë 28.5.2014, “Për sigurinë në det, plazhe, ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”, e ndryshuar (*VKM-ja nr. 321/2014*). Kjo VKM, e miratuar në bazë të disa ligjeve që lidhen me kufirin shtetëror, detar, mjetet lundruese, qeverisjen vendore, mjedisin dhe turizmin, përcakton rregullat minimale dhe të detajuara, të zbatueshme gjatë periudhës së sezonit turistik 15 maj–15 tetor, edhe për sa i përket sigurisë në plazhe, përfshirë edhe bregdetin, duke i ndarë zonat në plazhe publike (zona të hapura për përdorim publik dhe që ofrojnë mjete minimale për përdorim me kushtet e sigurisë dhe higjienës) dhe stacione plazhi, këto të fundit si struktura veprimtarie private nga personat fizikë ose juridikë. Pavarësisht ndarjes së zonave të plazhit, në publike dhe private, VKM-ja nr. 321/2014 përcakton se në çdo zonë ka një minimum masash sigurie, që lidhen me kufizimin e shënjuar të distancave të lejuara nga bregu, shenjat për lejimin ose jo të notimit, shenjat për plazhet e autorizuar ose jo, përfshirë ato për pasigurinë në notim në plazhet e paautorizuara, ofrimin e shërbimit nga vrojtuesit e trajnuar dhe pajisjen e tyre me materialet përkatëse, krahas vendosjes së kullave të vrojtimit.

31. Gjithashtu, në këtë VKM janë detajuar edhe përgjegjësitë e organeve shtetërore (subjekteve të interesuara), sipas hapësirës së kompetencave ligjore të tyre, me qëllim garantimin e kushteve të sigurisë në plazhe, në zonat çlodhëse edhe në bregdet. Këto përgjegjësi përfshijnë identifikimin e zonave të përshtatshme si zona çlodhëse, të konsideruara të sigurt dhe të shëndetshme për njerëzit, menaxhimin dhe administrimin e tyre, si dhe kontrollin dhe verifikimin e zbatimit të kushteve të sigurisë. Me fjalë të tjera, përgjegjësitë kanë të bëjnë me marrjen e masave dhe vendosjen e pajisjeve që synojnë uljen e rrezikut ndaj jetës së personave, të cilët ushtrojnë aktivitete çlodhëse në zona bregdetare të autorizuar.

32. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se familjari i kërkueseve ka humbur jetën ndërsa ishte duke notuar në plazhin e Divjakës, ngjarje për të cilën Prokuroria Lushnjë ka arritur në përfundimin se ishte aksidentale, e shkaktuar nga asfiksia mekanike si rezultat i mbytjes në det. Mbi bazën e vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, në të cilin përcaktohej se shkak i humbjes së jetës së viktimës ishte mbytja në det, kërkueset kanë ngritur padi në gjykatat administrative, duke kërkuar shpërblimin e dëmit, me pretendimin se organet shtetërore nuk kishin marrë masat për sigurinë e jetës në plazhin e Divjakës, të parashikuara nga VKM-ja nr. 321/2014.

33. Nën dritën e standardeve kushtetuese dhe në kontekstin e rrethanave specifike të rastit konkret, Gjykata konstaton se kërkueset i janë drejtuar gjykatave të zakonshme duke paraqitur pretendimin për shpërblimin e dëmit që lidhet me humbjen e jetës së familjarit të tyre, si rezultat i mosveprimit të paligjshëm të organeve shtetërore për të garantuar sigurinë e jetës dhe të shëndetit në plazh, sipas tyre në një zonë plazhi publik, pretendim i cili është me natyrë kushtetuese, sepse lidhet me të drejtën e jetës të garantuar nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i *KEDNJ*-së. Konkretisht, pretendimi i kërkueseve lidhet me detyrimin pozitiv të shtetit për të marrë masat e nevojshme për të përcaktuar faktet dhe përgjegjësinë e personave përgjegjës, si dhe për t’i ofruar dëmshpërblimin e duhur viktimës në rastin kur vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit ka ardhur si rezultat i neglizhencës së shtetit (*shih Sinim kundër Turqisë, datë 6.6.2017, § 59*). Për më tepër, detyrimi pozitiv i shtetit jo vetëm duhet të ekzistojë në teori, por duhet të zbatohet edhe në praktikë (*shih Sarishvili-Bolkvadze kundër Gjeorgjisë, datë 19.7.2018, § 90*).

34. Në vijim, Gjykata vëren se gjykatat e faktit nuk e kanë marrë në shqyrtim themelin e pretendimit të kërkueseve, duke arsyetuar se asnjë prej organeve publike të thirrura në gjykim nuk kishte përgjegjësi ligjore për ruajtjen e sigurisë së jetës në plazhin publik të Divjakës. Ato nuk rezulton të kenë verifikuar dhe përcaktuar fillimisht faktet që qëndronin në themel të mosmarrëveshjes, lidhur me zonën ku ka humbur jetën familjari i kërkueseve dhe shkakun e vdekjes së tij, për të shqyrtuar në vijim, mbi këtë bazë faktesh, nëse ishin të zbatueshme detyrimet ligjore për masat e sigurisë dhe shëndetit në plazh, si dhe nëse ndonjë organ shtetëror kishte



përgjegjësinë për zbatimin dhe për kontrollin e zbatimit të tyre nën dritën e kuadrit ligjor që rregullon masat e sigurisë në plazhe. Pavarësisht se, nga njëra anë, prokurori në vendimin për mosfillimin e procedimit penal tërthorazi ka pranuar se vdekja e familjarit të kërkueseve ka ndodhur në një zonë plazhi dhe, nga ana tjetër, neni 36, i ligjit nr. 49/2012, kur kundërshtohet mosveprimi administrativ, ia kalon barrën e provës organit publik, gjykatat e faktit kanë arsyetuar në mënyrë standarde se barra e provës i përket kërkueseve, në cilësinë e paditëseve. Për rrjedhojë, ato kanë interpretuar në mënyrë formale dhe *strictu sensu* kuadrin ligjor, interpretim që nuk ka marrë në konsideratë qëllimin e ligjit dhe, si pasojë, gjykatat kanë nxjerrë përfundimin se rregullat e sigurisë së jetës janë të zbatueshme vetëm në strukturat private të plazhit dhe se organet shtetërore në këto raste janë të përjashtuara *apriori* nga përgjegjësia. Ky interpretim i ngushtë i ligjit nga gjykatat e faktit duket se ka cenuar thelbin e së drejtës së jetës dhe kjo shkelje nuk rezulton të jetë korrigjuar nga Gjykata e Lartë, e cila ndonëse gjendej përpara një pretendimi me natyrë kushtetuese, ka vlerësuar se rekursi nuk përmbante shkaqe të parashikuara nga ligji. Në këtë mënyrë, arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar të drejtat e aksesit në gjykim dhe të ankimit efektiv të kërkueseve.

35. Në këtë pikë, Gjykata rithekson se raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme udhëhiqet nga parimi i *subsidiaritetit*. Respektimi i të drejtave kushtetuese është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Roli i kësaj gjykate, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, i cili shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të pretendimit të kërkueseve që interpretimi i kuadrit ligjor nga gjykatat e faktit mohonte thelbin e së drejtës së jetës, për sa u takon detyrimeve pozitive të shtetit. Mospranimi i rekursit të

kërkueseve nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin *de plano* të çështjes dhe me arsyetimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese, ka vënë në dyshim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore kushtetuese të kërkueseve.

37. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se në rastin konkret është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit substancial dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

38. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkueseve duhet të pranohet pjesërisht, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1447, datë 8.4.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 13.3.2025.

Shpallur më 10.4.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtare: Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini

**KËRKESË**

Shtetasja Lena Pemat i kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shpalljen të zhdukur të shtetasit Mark Pemat, i datëlindjes 13.4.1922, lindur në Iballe, Pukë dhe banues në Tiranë, si dhe caktimin e saj si përfaqësuese ligjore për administrimin e pasurisë në emër të shtetasit Mark Pemat.

KËRKUESE
Lena Pemat

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë

